



INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Tiranë, më 31 / 03 / 2023

Nr. 151/1 Prot.

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës datë 24.03.2023 'Kërkesë për informacion, detaj në lidhje me kthim përgjigje'.

Përshëndetje e nderuar

Në përgjigje të kërkesës datë 24.03.2023 'Kërkesë për informacion, detaj në lidhje me kthim përgjigje', administruar me Nr.151 Prot, datë 30.03.2023 në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (më tej IKRTK), Ju përcjellim informacionin si vijon:

- Lidhur me veprën e titulluar 'Portret Marinari', nr.Inv 498, KOD RKPK 157335 dhe me përmasa 64.2 x 47.5 cm, të regjistruar në Bazën e të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)", Ju informojmë se në zbatim të ligjit 27/2018 'Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë', neni 70 'Certifikata e Pasurisë Kulturore' pika 4: - Certifikata e pasurisë kulturore nuk përbën titull pronësie në kuptim të legjislacionit në fuqi apo kalim të drejtash të ligjshme.
- Pas verifikimit në Bazën e të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)", rezulton se vepra nuk përmbush kriteret për t'u konsideruar pasuri kulturore.

Gjithashtu Ju informojmë se, lidhur mbi pronësinë dhe posedimin aktual të objektit, me qëllim kryerjen e ndryshimeve në databazë të poseduesit dhe kalimit të të drejtave, Ju lutemi të na vini në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe bazën ligjore.

Referuar, kërkesës për vënie në dispozicion të çdo informacioni mbi veprat e krijuara nga Znj.


- Në zbatim të ligjit nr. 55/2018 'Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to', si dhe ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', nuk mund të ju përcjellim informacion mbi veprat e krijuara nga) dhe të

regjistruara në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK), pa provuar më parë lidhjen me personat e lartpërmendur.

- Lidhur me veprat e krijuara me autor Zi _____, pas verifikimit në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK), rezulton e regjistruar vetëm 1 (një) vepër me emërtim ‘Portret Marinari’, KOD RKPK 157335, në posedim të _____

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR



Sokol MUÇA

